

MAKU
PONE

BIBLIOTEKA
SHTETIT

SH-1
p 85

yje
mbi
bar

vjersha


854-1
P 85

MAKU PONE

S

YJE MBI BAR

VJERSHA



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

PORTRETI I VANGJEL LAMIT

*Në kooperativën bujqësore të
Grecallisë Vangjeli Lamin e
kanë njohur të gjithë dhe e
kanë dashur të gjithë...*

Pas buzëqeshjes tënde, —

arat e paanë.

Shtati yt

njëqind rrënjë pambuku njëherësh përfshin.

Shoh në sytë e tu brazdat e hapura,

brazdat që mbajnë

farat e reja që kanë zënë të mbijnë.

Flokët e dëndura

si një tufë fijesh bari

era e ngrohtë e prillit t'i përkund.

Duart e tua —

të mëdha e plot vena,

balli —

i qetë, ende pa një rudhë.

— Dhe mjafton që ti me duart
të prekësh plisat e butë në ugar
e si plug t'i futësh thellë në tokë
dhe do të mbijnë luledjelli me kurorat —

ar

dhe pambuku —

dëborë

do të bjerë në bohçe flokë-flokë.

Vetëm një grimë, vetëm një grimë duart e tua të
shkojnë

dhe të derdhet qumështi-mjaltë në kova
dhe rrugët e kooperativës qumësht të kundërmojnë.

Mjafton që ti

pemishtet t'i vështrosh —

dhe zë e çahet pjeshka

dhe piqen zerdelitë

Dhe rrushtë rëndojnë në vreshtë e në kosh,
kërcyell i misrit thyhet nga kallinjtë!

Mjafton që ti

të hidhesh në valle

e lehtë si mjegull,

si pemë me lule —

e bukur

dhe do të të vënë në mes djemtë
si venë retë

malet

dhe do të kundrojnë me sytë e qeshur, të lumtur.

Dhe kur në mes valles

sytë e tu të kthjelltë

papritur dikë do të pushtojnë, Vangjeli,

do të çahet një def,

do të krisë një kënetë

dhe grimcat e pluhurit do të bien si oriz.

Dhe kur në dasmën tënde

fusha

si dasmorë të nis boçet e pambukut, bostanet e
pjekura e rrushtë

dhe unë, Vangjeli,

në s'ardha atë ditë

vargjet e kësaj vjershe

do të ti sjell si krushq!

KUR VJEN PRANVERA...

Dëbora shkriu...

Era e ngrohtë drurëve
u lëkund kaçurelat e gjelbra tani.
Dhe zënë e bredhin fëmijët
përtërihen të rriturit,
ç'mrekulli, ç'mrekulli!

Toka gufon, s'i mban dot lulet,
edhe shkëmbi pëlçet e lule nxjerr,
retë shkrifërohen
si grifa të bardha,
qielli ngjyrën e qumështit merr.

Kuajve në buzë u bie erë e barit,
u bie erë e tërfilit në kokë
dhe s'qëndrojnë të mirët një grimë në stalla

dhe duan të mbrihen, të fluturojnë me karrocata!

Kërcejtë e njomë të grurit pushtojnë njëri-tietrin,
pa vështro, sikur thonë, ç'tokë e butë, ç'tokë e
ngrohtë...

Dhe puthen nga gëzimi —
sikur më shpejt duan të piquen
e të ronisin në hambarët e rinj kokrrat.

Rreth telave telefonikë cicërijnë zogjtë
sikur të kenë marrë lajmthirrjen e parë
pranverore..

gjithshkaje: barit e drurëve, zogjve
e kuajve të mirë në
stalla
pranvera u dha diçka më të re, më tokësore...

NJERIU QË QESHI PËRBALLË VDEKJES

Ramiz Varvaricës

Re.

Shokët shkundën nga flokët pluhurin dhe ciflat
e predhave,

mposhtën dhëmbjen

në sy,

mposhtën hidhërimin e humbjes në zemra,
të humbën

ty.

Re.

Malet e Spanjës u tronditën nga ajo humbje.

Kur u ike ti

sikur u iku përjetësia e borës, bukuria e
mjegullnajave...

Tokës spanjolle

i dridhej në sy imazhi i rrallë i grunajave.

Mijëra kilometra larg
malet e Shqipërisë tronditjen e maleve të Spanjës
ndjenë,
nga ajo humbje e thellë
gurgulluan,
lëvizën,
u shtynë
sikur pranë teje vetëm për një çast të venin.

Ike Ramiz, me atë qeshje të madhe
që na hyn në zemra
nga fotografia jote
ti kështu afroresh drejt nesh —
me atë heshtje
ti mbete si njeriu që dinte të qeshte më bukur në
botë.
Kështu mund të qeshin vetëm ata që dashurojnë
që dinë të vdesin për tokën e për njerëzit.

LIRIKË

Hyri grigja me këmborë në këngën e saponisur të
mbrëmjes,

aromat e qumështit

pikuan

mbi kristalet e vesës në barin e dendur.

Dhe erdhi baresha

Këngën mbi kullotë

e përtej staneve duke shpërndarë.

Të dukej se kish vënë pranë çdo tingulli

një qëngj leshbutë,

të bardhë.

KUNDËR INDIFERENCËS

Vijnë në ditët tona të bukura, vijnë në qiellin
tonë të kthjellët

re të papritura,

të zymta,

të zeza,

që duan të prishin bukurinë

e të shtunave, e të djelave, të mëngjezeve e
mbrëmjeve,

që shtjenë me kërcëllima,

që hedhin vetëtima.

E megjithatë, këto s'janë gjë,

këto janë teke të qiejve,

aparenca.

Ka diçka më shqetësuese se gjëmimet në ditët
e bukura.

E keni vënë re

si qëllon,
si godet
indiferenca?

Si tension miliona voltësh të reve të ngarkuara
të përçon belbëzimi i akullit: «Ç'më duhet?»

Po ne s'duhet të rrimë. Këtë tension të pamatë
t'ua hedhim, shokë, indiferentëve në serrat!

E HERSHME

Mbrëmja — e paanë,
mbrëmja — e thellë,
retë

si vela
rrëshqisnin në qiell.

Kopshtet sillnin erë
tërfili e bari,
zu vesë të binte
mbi lulet e dardhës.

Ti-një pjesë e mbrëmjes
në prëhër të saj,
parfum toke,
lulesh
nëpër flokë mbaje.

Që nga stalla vinte
aromë e kulloshtres,
s'kish gjë më të rrallë
se kjo mbrëmje, ndoshta.

Viç' i njomë nidhej,
harbohej mbi bar,
ç'ngjyr' të kaltër sytë
ty të kishin marrë.

Dhe era që shkundte
petalet përtokë
me gishtat e mi
të mbeti në flokë.

NJË PARTIZAN

Ndodhi kështu: ai mbeti i rrethuar
Kur tym' i betejës ende s'qe rralluar.

Malet nën këmbë, retë mbi kokë,
acari përplasej e thyhej copë-copë!

Tridhjetë ballistë,
një partizan,
tridhjetë pushkë
me një nagant.

Tridhjetë pushkë,
tremijë fishekë,
jepi, u çafsh, nagant i nxehtë!

Malet nën këmbë, retë mbi kokë,
çaje, nagant, e u bëfsh copë!

Retë u ulën,
u përgjakën retë...
Ç'pate që heshte,
nagant i nxehtë?


VDEKJA E AGRONOMIT

Në duar —
pak dhe,
dhe dy fletë të blerta,
dy kërcuj të njomë:
gjelbërimin sikur të merrje me vete
i paharruari agronom.

Në stallë s'mbahej kali nga hidhërimi...
Lopët

tërë gjirin e fryrë e shtrydhën këtë ditë
që të pije një kupë qumësht më shumë
kur të shlodheshe në mesditë.

Arat e kuptuan ikjen tënde
dhe dërguan pa ndërprerë shushurima...
Në pjeshkët e arrira
kokrrat u shtrydhën nga dhembja.



Dhe të vunë kooperativistët tek koka
ca fije gruri...
Dhe thanë: «Kështu vdes i miri,
kështu vdes burri!...»

AI

Ai
për të shqetësuar mendimet e tua erdhi.
Unë e njoh. Unë e di vështrimin e tij të
mprehtë:
ai është i zbrastë,
ai është i zbehtë.

Ti nuk je ndonjë këngëtare e madhe,
atij këtë

mos ja zerë besë.

Kur këndoje
të regëtinin në sy të mbjellat në ara,
peisazhet jugore sterpikur me vesë.
Kënga në buzë
si lule të mbinte...

Por ai —

nuk do këngën
dhe në mendime kënga jote s'e shtie.
Kujdes, vajzë:
merimanga... end fijet.

PAPA KRISTO NEGOVANIT

Nga buzët e natës helm kulloi, në vend të pikave të
vesës,
malet kulluan jo dëborë të shkrirë, po pika, pika
helmi,
burimet
ndjenë si ujërat e tyre u frynë nga një hidhërimë
e mprehtë
dhe gurët
dhe zajet
anëmbanë u çanë nga curkat e helmit.

Shqipëria
me thërrimet e bukës helm nga helmi që të dhanë,
mori.
po nga jeta e jote e madhe

mushtin e ëmbël të shpresave nxori....

Dhe mbetet, Papa Kristo, si një det mushti....

PËR TY

S'dua të të krahasoj me asgjë, e dashur.

S'dua të ngatërroj erën nëpër flokët e tua
kur vetë si erë mund të pushtoj në faqe e duar!

Ti ke më shumë se krahasimet më çapkëne,
më shumë se vargjet e mbushura me dritë hëne.

FIERZË

Do të ketë ca lule më pakë
dhe më pak ca drurë veriorë,
në ca kilometra katrore.

E dimë

s'do të ketë më dëborë:
ujërat e liqenit do të ngrihen mbi lulet
dhe mbi rrënjët e drurëve të bukur veriorë
dhe —
s'do të habitemi
kur nga llambat mbi ujëra do të mbijnë lule
bore.

Qysh tani
mbrëmjeve të qeta kur rri e mbaj vesh
dallgët e liqenit më shushurijnë në vesh.

MOTOBARKA E VJETËR E PESHKIMIT

Në ballë: të çarat si rrudha të dendura, të
thella,
në direkë: shkuma e valëve si thinjë.
Ecën. Diçka përherë të kërcet,
ndjen dhembje,
hesht.
Ecën përsëri
midis shoqesh e shokësh të rinj.

Secili në breg
të përcjell,
të pret.
Vetëm deti me dallgë
pa rreshtur të godet:
«Mposhtu, sikur thotë, mposhtu, këtë çast!»
dhe prapë të hedh stërkala
dhe të mbulon me ujëra....

Deti
sikur forcën e vet
me tënden, motobarkë, do të masë.

Peshkatarët e dinë:
ti mposht jo vetëm detin,
ti mposht
pleqërinë!

SHESHI I TAKSIVE NË VJESHTË

Në sheshin e taksive në vjeshtë
makinat
si në rivistë
në rrjesht.
Shoferët
agrepat e orës së pritjes shtyjnë
me kokat mbështetur mbi biseda të gjata
në vëzhgime,
gazeta,
debate.

Dhe gjethet e drurëve që enden në ajrin e
qullur, që bien
ngjajnë si ftesa martesash të vajzave e
djemve.

EPISOD

Ata erdhën natën në mullirin e vjetër,
ku përreth veç myshk e bar të thatë kishte.

Qielli —

kube,

i mvrejtur

kullonte shi mbi ahishte.

Qenë lodhur trokashkat e pushonin në gjumë,
mjegull e miellit

ende s'kish zënë vend.

Partizanët e kishin mbështjellë me gunë
shokun, plagosur rëndë.

Ende s'u ish tharë djersa (me pika shiu përzier),
dhe flokët u mbanin ende erë barot.

Ata hynë në mulli të heshtur,

mbi vig —

një shok.

Dukej sikur flinte ai në një gjumë të thellë
me ëndërra të bardha

si mielli i sapobluar...

Ujët rridhte kthjellët,
ujët rrinte zgjuar.

Ç'të bënte mullixhiu plak atë natë:
shtroi ca bar e një thes mielli i vuri nën kokë.
Era e bukës përhapej
e dashur, e ngrohtë.

Ikën shokët t'i binin pas çetës,
lufta ish e ashpër
dhe tymi ende s'qe shpërndarë...
Partizani rrinte si mes ëndërrash të qeta
në gjumin e parë.

Dhe i ndënji mullixhiu gjithë natën mbi kokë,

ja ndërroi plagët shtatë herë
dhe shtatë herë i shtrydhi
në ballë shami,
mbështetur në brinjë përtokë
bri tij.

.

Në mëngjez u zgjua i plagosuri i lehtë, i përtërirë
dhe plakun pa me sytë e mbyllur
e kokën mbi gur mbështetur,
plakun e panjohur,
bri tij të shtrirë
që ngjante se kishte fjetur.

Por mullixhiu papritur u ngrit —
ju duk shumë e rëndë
qetësia e pak minutave atij plaku të urtë...

Në qiellin pa re
qe ngritur shtatë pëllëmbë
dielli i madh e i butë,

NË AUTOBUZ

Çelën lule mbi xham,
lule të bukura cingërimë.
Na duket sikur na i hedhin kalimtarët
e na mbulojnë me lule.
urime.

Sikur na përshëndesin rrugët dimërore
dhe si telegrame urimi
retë dërgojnë fluturza bore.

MODE

Modat papritur bien si shira:

«kjo u vjetërua,
e ç'ka kjo të mira?»

Dhe flokët zënë varen si shelgu lotonjës...

Dhe flokët zënë varen si shelgu lotues...

të bukurat,
të thjeshtat!

Ca- takat të ulta,

Ca- takat të larta,

fustane të gjelbra,

fustane të kaltra.

Atëhere të shqetësuar ne themi: «Ç'ndcdh,
vallë?

Po ka ende modë

në poezi:

«ku ka si filani? Ah, vlen sa njëmijë!»

Dhe mbin si një pemë e nevojshme, plot jetë
poezia —

pà modë,
me kokrra,
me fletë...

VETËM DHJETË DITË PRANVERË

Vetëm dhjetë ditë pranverë
dhe nga të mjellat

tokës

po i çahet prehëri.

Vetëm dhjetë ditë pranverë
dhe harbohen motivet, —

të lehta,
pjellore,
transparente.

Në tryezën e poetit, —
incident:

ngatërohen vargjet
me fijet e grurit,
strofat

në parcelat
mezi çajinë udhët.

Këto s'janë vargje,
këto s'janë strofa
po bimë
dhe lule,
që mbijnë nga toka.

FAMILJARE

Fryn era në postrehë, rrjedh shiu në ullukë,
soba na ngroh e na deh me avuj të butë.

Mbi projekt-diplomën gjithë mbrëmjen motra rri
sikur të jetë një vëllim i këndshëm me poezi.

Gjyshja mundohet përin të shkojë në gjëlpërë,
flokët si penj të bardhë nën shami i nderen,

E mira nënë diç kërkon në bufe:
Mendon për tryezën e darkës, për ne.

Vjen e rri pastaj mbi kokë të lirikës sime
duke i shtuar diçka më të ngrohtë, më intime.

Vogëlushes Sonila i lot gjumi në qepalla,
Gjyshes prapë e pambaruar i mbeti përralla.

ÇAST

Të pashë si u krodhe në stërkalat e bardha,
të ngatërova papritur me pulëbardhat.

Ja përmbi dallgë ti dc të fluturosh,
që të më pushtosh
mua dhe detin

.....

KËNGËT E XHA QERIMIT

Bëri ftohtë atë fund dimri, madje ra dhe dëborë
në fushat pambarim të Myzeqesë.
Mbërdhinë nën leshtë e dëndur deshtë me
këmborë,
ndërsa mëllënjat ja thoshin këngëve të haresë.

Ne erdhëm në fshat e shumë vend tek xha Qerimi.
Na priti plaku me dorë në zemër e me bukë e
kripë.

Ende nuk kish rënë në drurë blerimi
ende nuk kish mbirë bari ato ditë.

Xha Qerimi bënte kafe të mirë e duhan të fortë
pinte,
xha Qerimi thoshte: «Mblidhni sa më shumë
këngë».

Ë lumtur

midis të lumturve rrinte
dhe mposhtte në vete çdo brengë.

Sa këngë bardi plak kishte ngritur,
ku të mundtte —

në meranë e pafundme me bar,
ulur mbi poplat,

nën diell i përzhitur,
mbi tragjedinë dhe lumturinë e popullit ish
mbështetur,

kish qeshur,
kish qarë. . .

Po s'e dinte ai plak i mirë se një fund dimri
do t'i vinin mbledhësit e folklorit në shtëpi,
këmbëkryq bri tij do të rrinin
dhe lule do të mblidhnin nga shpirti i tij.

Se kish mbjellë shumë lule xha Qerimi në këngët
e tij,
se kish vënë gjithë zemrën dhe bukurinë e tokës.
se kish hedhur mbi këngë shumë dritë.

ajër
e kaltërsi

.....

Po ato ditë mbaroi i miri xha Qerimi
duke pirë duhan të fortë

e dy tri këngë pa na i thënë
gjer në fund

ne hodhëm në varrin e tij nga këngët blerim,
që pavdekësia e popullit

në shekuj ta përkundë

UNË DHE TI

Unë dhe ti
nga më të zakonshmit ndërmjet mijrave
që baltrat e fushave u mbështillen në këmbë,
nga mëngjezi në mbrëmje,

unë dhe ti,
që në brendësi të tokës kemi rrëmirë
që çdo qelizë e saj
të bëhet më e rëndë nga prodhimi,

unë dhe ti
që në brazda kemi njohur vetëveten më thellë,
më mirë,

unë dhe ti
që agimin në fushë e kemi pritur si lajm të
gëzuar
me rrjeshtat e bukura të rrezeve të diellit
në flokë,

me ajrin transparent
në mushkëri,
me veshat e rrushit të pjekur
mbi kokë,
me fytyrën e dashur të njëri-tjetrit
në sy,

unë dhe ti
që do të shkonim drejt gjithë bukurive të botës
mjaft që të na thërriste,
mjaft që të na bënte zë
vizioni i dashur i tokës...

SALDATORES SË PARË QË NUK IKU NGA KANTIERI

Ik, të tha, ti je e tepërt, je si një lule që mbin ende
pa kaluar ngrica
ti ke nevojë për hapësira,
për rreze të ngrohta dielli,
ik, vajzë, këtu netët janë nga më të ndryshmet,
kanë ato baticat dhe zbaticat
ik, ik!

Po baraka që e madhe
dhe njerëzit —
të mëdhenj.

Ngricat shkrinin mu pranë frymëmarrjes së tyre
të ngrohtë,
luleve të akullta në xham
lulet e mrekullueshme të lofatave vendet ua zinin...

Ti nuk ike.

Ai zë i vockël t'u duk se vinte nga një ëndërr e
largët, e keqe

që para zërave të shokëve
në copa thyhej
si qelqe.

Kur pranë rrezatimet e para të saldatriçes tënde
menduan: ky është dielli —

metal i shkrirë

që xixa kullon, kullon...

• • •

Pellgje. Ujët-liqej miniaturë.
të vogla pellgjet
sa s'përmbysen në pasqyrim të plotë as dy drurë.

Pellgje vjeshtore, u shoh si i ftoni fëmijët:
«Anijet lëshoni, udhëtim të mbarë!»
Vrapoj dhe unë
pëllëmbët t'i njom,
të më mbetet në to bardhësi e stërkalave.

S'do të druhesha të bija më gjunj
dhe buzët t'i mbështesja
këtu.

S'jam rritur unë
dhe s'jeni rritur ju.
Po në punët e mëdha e të vogla të ditëve
harrojmë një bukuri të thjeshtë
ja si kjo: e papërsëritëshmja e pëllgjeve
dhe në përgjithësi themi: «je e bukur, vjeshtë!»

ZGJOHU VAJZË!

Amar dës

Zgjohu, vajzë, a të tha babi mbrëmë
se dielli do të zbresë në dritare
si një lule e bukur — e bukur
mbështjellë përreth me fije ari?
Zgjohu, vajzë, a të tha babi mbrëmë
në parvaz të dritares do të çelin kumbullat
e do të fërfëllijnë mbi xham
si krahë të lehtë pëllumbash?

A të tha babi se do të bjerë dëborë
e bardhë-e bardhë, e pambarim,
pa vështroji, vajzë, këto petale
a nuk bien si dëborë papushim?
Zgjohu, vajzë, të shohim retë e bukura
që ecin në qiellin si kope delesh,

ngrehu, doçkat t'i zgjatësh,
ngrehu, t'i përkëdhelësh...

Zgjohu, vajzë, të shohësh makinat
si po mbushin tregun me rrush e me mollë...
A të tha babi mbrëmë
se dhe zogjtë me cicërima do të venë në
shkollë?

NE S'MUND TË HESHTIM

Ti je bërë i njohur. Thonë... i dalluar
askush në tabelë të nderit vendin tënd s'e prek,
me një nënqeshje të madhe

fiksuar

ti rri plot 365 ditë,
plot 365 net.

Dhe lulet përçark sikur për ty kanë mbirë,
të gjelbra,
të bardha.

Aromat.. .

Askush s'të merr nëpër gojë, përkundrazi... .

Me vështrim të mendueshëm

antenat e kullave

dhe njerëzit

ti kaq kohë kapton.

Dhe ky je ti.

Je ti që nëna plot gjashtë muaj të pret,
nëna e plakur, e thjeshtë, e mirë,
që kurrë nga djali

nuk mori një «cek»,
që një pusullë nuk mori:!
«E dashur... yt bir...»

Që pret...

Që flokët e tua të dëndura
t'i derdhen në prehër, t'i derdhen në gji
dhe sytë e saj të njomen nga malli
dhe ti para saj
të jesh prapë fëmijë.

Që mbrëmjeve pranë sobës
të të numurojë me gisht
çupat e lagjes që për nuse u bënë...
dhe ti të ulësh sytë

(Ti-prapë si fëmijë)

dhe të thuash nënë buzë: «E kam gjetur, nënë...»

Dhe netve të ftohta

të të rrijë **tek koka**

dhe thinjën **e parë**

dhe dorën e dashur të të shkojë në flokë

vazhdimësinë e vet

tek ti duke njohur.

Në stacionin e zhurmshëm të të përcjellë qëmenatë:

«Shkruamë për vete, për nuse... kantjerë!»

dhe në çantën moderne plot reflekse të bukura

një petull të ngrohtë më shumë të të shtjerë.

Por asgjë e tillë. Ti veç hesht.

Në tabelën e nderit

i ftohtë, si brymë.

Shokët e kantjerit këtë nuk e dinë,

as të komitetit profesional nuk e dinë.

Se nënat ankesat s'i hedhin në posta

si lutje të zgjatura, të shpeshta

për zgjerim,

dhembjen nënat

si pas njëmijë portash

e mbyllin

dhe heshtin.

dhe në pritje rrinë...

Eh, ti je bërë i njohur, thonë, i dalluar,

askush në tabelë të nderit

vendin tënd s'e prek...

Vetëm zëri ynë i zemruar,
dëgjon?
Edhe në dhjetë mijë tabela po të ngjitesh
do të të ndjekë!

PËR THASHETHEMET

Dy gra se nga erdhën e ja rrënuan shtëpinë
me ca zëra të vrazhdë,
me ca zëra të këqinj.

Si nuk po thyhen trarët e shtëpisë
nga pesha e kaq njerëzve që dalin nga gojët e
tyre të mplakura

ku fjalët fëshfërijnë
si fije bari të tharë?

Njerëzit
shtyjnë njëri-tjetrin,
nguten

sikur nga breshër i papritur
s'dinë ku të futen.

Po shemben muret —
trarët kërkëlljnë!

Nënë,

që do të mbaje mbi shpatulla njëqind shtëpi
po të binin
si mund të durosh këto dy gojë zjarri me
lëkurë gjarpëri mbështjellë,
që nën buzëqeshje të shtira
mund të minojnë një kështjellë?

IKJA NGA PLAZHI

Dhe pista e vetmuar mbeti pas mjegullash e
ujërash,
e mbushur me kokrizat e arta të rërës...

Dhe flokët e tua të shpërndara mbi kum,
klithma vjeshtore e pulëbardhave mbi molo
dhe dallgët që treteshin nënë këmbët pa zhurmë
dhe shkëmbi si i dalë nga rrenojet arkeologjike
i prerë në mes

nga stërkalat dhe era
dhe mbrëmjet që peshk kundërmonin

e kripë —

Të tëra i kishim
dhe tani po ikim.

Degët e plepave si linja telefonike
bisedat e gjata të vjeshtës filluan:

— Alo, mos ikni!

Alo,

ju deshëm...

Qiellin vetëtimat e dendura përçuan.

Vagoni ka vend për të gjithë: për njerëzit,
që si në ekran të pafundmë shohin detin dhe
rërën.

ka vend dhe për zogjtë,

për plepat,

për mbrëmjet...

Vetëm s'ka vend për trishtim.

Trishtimin e shkundim si grimcë prej rëre.

MBRËMJE

Afishet e fundit të sezonit lëkunden mes ajrit me
lagështirë ngarkuar.
Lexoj ftesën që më josh në ballin e tyre nga era
çjerrë.

Eci.

Përthyerhet heshtja,
zhurma e mbrëmjes fluturon si një tufë
zogjësh të shqetësuar
diçka kërkoj e kërkoj në këtë mbrëmje të gjerë.

Ku je, them me vete,
shokët ku janë,

ku janë ata që ende s'i kam shokë
(po që diku në udhëkryqet e jetës do të njihemi),
ku je, vajzë, që aq shumë do të të deshja,
që nën këto reklama të më prisje
në këtë mbrëmje të ngrohtë.

Ku është, them, dashuria ime ku është?
Ndofta midis këtyre vajzave të bukura këtu nën
dritën e bardhë të neonit.

Do të vijë si surprizë në fund të sezonit?

LETËR NGA EKSPEDITA

Fryjnë erëra të dhjetorit,
cingërimë.

Në gryka e hone pesë net rrjesht bie borë,
ujërat si stalaktite mu para syve ngrijnë.

Ndërsa ti më shkruan: mjaft!
Braktisi të tëra, ti më shkruan,
erërat e akullta, dëborërat e çmendura,
të gjitha braktisi për mua.

Është një dhomë e ngrohtë, e di.
Dhe shtrati i butë është —

ç'të them.

sikur u mbaruan puplat!

ka dhe xhiro,

sa ka ujëra e ujëvara tek ne...
Dhe filma shfaqen nga më të bukurit.

Të tëra i di.

Di që ti pret e përcjell miqtë e shumtë,
pret dhe përcjell ditët dhe netët e tua të gjata
pranë sobës

ku digjen drutë
me një nanuritje monotone, të thatë.

Në ekranin gri të mbrëmjeve të tua
gjërat e vockëla parakalojnë si një grumbull resh
vjeshtore me shi,

Zbrazëti në mendimet e tua,
në sytë e tu —
zbrazëti.

Vetëm një gjë nuk e di ti,
vetëm një gjë:
Orteku një shok dje na gëlltiti,
o, s'mund të hesht tani për këtë!

Harta gjeologjike e fundit në gjoks —
në ngrirë,
si fotografia e së dashurës, po ta kishte...
Ishte djali më i ri, ishte djali më i mirë
si mund të jetë një djalë pas dy vjet
ekspeditash.

Na iku.

E madhe qe dhëmbja.

S'mund ta matësh me asgjë. Po, me asgjë!
Ndërsa ti mërmëritesh...

Tek pret e përcjell miqtë

dhe asgjë nuk di e nuk do të dish për të!

PËR NAUN PRIFTIN

Kollitej Myzeqeja me mushkëritë bërë vrima.
në gjoksin e saj —

shkretëtirë e tokave djerr.
në barkun anemik e gërryente uria.
pikonin në zemër të saj moçalet vrer.

Në fushat e pafundme —

ngjyrë e verdhë, zbrazëti.

ditët —

të mugta,

netët —

të errta,

po nga më e dhimbshmja thellësi e zembrës së popullit
erdhi fjala jote, Naun, që digjej nga jeta.

Dhe barërat e mbira mbi kashtë të kasolleve

(Ç'miniaturë e gjallë e grunjave që do të vinin!)
fërfëllonin

nën erërat e ngrira dimërore

Dëgjonin pleqtë dhe kokat e bardha tundnin:
do të ketë shumë grurë e do të ketë shumë bukë,
do të pëlcasin, thua, tundësat nga qumështi
dhe do të pëlcasë toka nga fara e butë!

Ç'thua, djalë, ç'thua!

Kjo është ëndërr

dhe ëndërrat të cëmbojnë, të ngrijnë...

Kaq grurë lëmenjtë, kaç grurë do shijnë?

Ç'thua djalë, ç'thua...

Fëmijët zgjatnin kokat e vogla leshverdha:
do të tingëllijnë zilet e dashura në shkollë
dhe do të hamë rrush të pjekur —

e pjepra

dhe do të ngopemi, thua, me mollë?

Dhe nga arat sikur vinte krismë e bostanit
tek çahëj,

i ngopur me lëngun e vet.
tundnin kokat leshverdha fëmijë,
tundnin kokat e bardha pleqtë.

Strukej në saraje dhëmbëckërmitur beu,
sarajet në themel parandjenin bubullimë.
Xhandarmëria u binte këmbanave të frikës, —
ky është rrebelim,
ky është rrebelim!..

Po ti

i dashur sa toka e sa gjelbërimi
gjëndeshe njëherësh në njëmijë kasolle...

Nga ngarkesa e fjalëve të tua Naun
po flakërinin vetëtimat e revoltave popullore.

PAS CA DITËSH

Pas ca ditësh do të vijë vjeshta.
Këtë e shoh në gjinjtë e fryrë të hurmave
të pjekura,
në rrushin që po pikon në vreshtë,
në retë e harbuar në qiej,
nga erërat e zhurmshme të
ndjekura.

Do të vijë vjeshta.
E ndjej
si më të ngjeshura bëhen strofat,
madje
nga pesh' e frymëzimit
thyhen
në vargje të lira
si për të thënë më shpejtë shqetësimet e
stinës.

PELIKANËT NË TREGUN E PERIMEVE

Ja pelikanët e bardhë, tha, diçka e akullt, dimërore,
diçka e zbrastë,
pakuptim.

Pa vështro:

Mbi male e nën male —

cingërimë dhe dëborë.

Ç'duhen këta pelikanë porcelani, pra, ç'duhen?

I vështron

dhe të ngjallin trishtim...

Pa dëgjo, do t'i thosha, njerëzit duan gjithmonë
pranverën afër ta kenë,

dashurojnë

vizionin e saj të bardhë,

vizionin e saj të gjelbër.

Në sfondin e drurëve të zhveshur, nga dëbora
përthyer

secili nga pranvera

diçka të veten gjen.

Do t'i thosha edhe për shqetësimin e skulptorit
që e shkëputi nga zemra

dhe e vuri mbi këta pelikanë,

do t'i thosha...

Po nga drurët ca flutura bore të kristalta
atë çast, si petalet e para të pranverës
ranë.

VETËM HEROI RRI ZGJUAR...

Ora 24.

Zakonisht në këtë orë mbyllen portat,
bien
të përgjumura perdet pas dritareve
dhe s'kërcasin më dyert
dhe s'kërcasin më shkallët.

Urbanët e fundit po shkojnë të shlodhen,
trenat e mallrave nxitojnë, bosh të mos
mbeten shinat.

Më çudit qetësi e mesnatës,
zbrazëti e mapove,
shkëlqim i vitrinave.

Zhurme e njohur e fletëve
të tërin më mbështjell

tek eci përmes rrugës së dashur «Dervish
Hekali»,

flë gjithshka

në një gjumë të qetë të thellë...

Vetëm heroi me sy përjetësisht të pagjumë
vështron nga piedestali.

ALO!

Alo!..

Diçka e ngrohtë shpërthen drejt e nga
receptori.

Alo!

Këtu s'ka qindra kilometra largësi,
ky është receptori,
është dora jote.
e dashur, mu përpara meje je ti.

Ti, — kudo, kudo me mua.

Dhe vetëm tani

thjeshtë

dorën tënde të ngrohtë e të butë zgjate

dhe nga buzët e tua

e papërsëritshmja fjalë më përçoi të tërin

si një rrymë e njohur — e njohur:

Të dua.

VAJZA E MONTATORIT

Dikush pret një letër me shqetësimin, e dashur,
në zemër (do të vij?)
dikush pret të dashurën që s'e ka parë prej
një muaji.

Montatori i vjetër Gani
priste vajzën e vogël e të mirë Luli.

Kur erdhi
gjithë fëmijë e krahinave sikur u mblodhën,
sikur mbinë nga toka mijra lule,
lule në barakë e në tabllonë e varur mbi mur,
lule
në tryezat e shtruara për drekë në mensë,
lule —
mbi retë e ngatërruara në antena e
kulla,

në fytyrat dhe flokët e shpleksura të montatorëve — lule.

Kantjeri i largët atë ditë ngjau me një kopësht ku kish vetëm sythe, aroma dehëse, transparente, në vajzën e montatorit të vjetër Gani

secili

ngrohtësinë e të dashurve të largët gjente.

TANKISTËT SHKOJNË NË STËRVITJE

Dridhet toka e tërë sikur gjëmojnë qiejt.
E megjithatë një re syri s'të sheh.

Ç'të jetë kjo oshëtimë e pambaruar?
Sikur shtërngata shpërthen hapësirat,
sikur po thyhen drurët
e bari s'mund të ngrihet,
dridhet toka,
gjëmojnë qiejt.

Vështroini: tanket po çajnë në rrugë e ndanë të
mbjellash,
tanket shkojnë në stërvitjen e lodhshme e të
gjatë,
të lagur në pellgjet e udhëve, —
si me djersë,

mbi supet e rëndë
ngarkuar me baltë

Mbi zinxhirë kanë mbetur ca lule të freskëta
fushe
që Atdheu i ka hedhur tufa-tufa...

PËRCJELLJA E AKSIONISTËVE

Diç duam të themi,
po në vend të fjalëve lule bien.
Kështu shpesh na ngatërrohen në përcjellje
fjalët e pa thëna me buqetat e posa këputura,
në një stacion treni.

Mbi vagonat sikur kanë mbirë drurë të mëdhenj
flokëdendur
dhe ju na përshëndesni mes gjelbërimit që dall-
gëzohet
dhe hapësirave që përcjellin këngën tuaj.

MONOTONI LETRARË

Gjinkalla
çahet më dysh nga vapa
pasi përsërit njëqind herë një këngë.

Ndërsa ti
me zbrazëtinë e mendimeve
nuk di ç'kërkon,
nuk di ç'të dhëmb.

Po të ishe gjinkallë
pa tjetër një ditë do të kishe plasur,
në grimca do të ishe ndarë...

MALLAKASTRA

Tek të vështroj
çdo gur, bokërimë apo arë të sapo
mbjellë
më ngjajnë si kështjella.

Dhjetë, njëqind, njëmijë kështjella
pa mure gurësh e pa bedena.

Njëmijë kështjella, —
e në vend të gurëve
grurë.

Dhe
po të duhet:
në vend të grurit, —
plumba.

Kështu të shoh
ty, — të renë,
ty, — të lashtën
kështjellë e mirë dhe e ashpër
Mallakastër.

E SHKRUAR PËR LUMIN GJANICA

Bjerë, o shi, bjerë!
Mbi gjethet e plepave
kullo,
nga strehët e ullukut
piko.

Sa të mundësh dërgo ujëra të reja
mbi Gjanicën e qetë poshtë brigjeve
e drurëve.

Bjerë.

E dimë që Gjanicën as Nil e as Danub s'do
ta bësh,
ajo e tillë do të mbetet, ndonëse në gjoks
do t'i mufaten ujërat e tua.

E tillë do të mbetet:

e vockël,

e dashur,

më e dashur se gjithë lumenjtë e botës, me
ujëra të verdha e blu.

TREGIM I NJË NATE TË VITIT 1942

Nata —

e pafundme, e rëndë, e shkretë.

Coprifuoco-ja

dridhej

mbi brinjët e ngrira të trotuarve.

dridhej

në postëroje

me ethet më të tmerrshme —

me temperaturën 40.

Ne rrinim pranë zjarrit —

ai qe tepër i ftohtë,

kullonte qiriri në vatër —

e prapë qe errësirë,

cingërimat

nën trarë

na binin mbi shpatulla.
na binin mbi kokë
e si gjarpër na mbështilleshin
në trupin e mërdhirë.

Te porta —
patrulla.

Çizmet godisnin mbi shpinë të natës,
mbi gjumin tonë.

Heshtje
në rrugë,
në dhomë.

Dhe papritur diçka kërciti, anembanë u thye
heshtja,
u lëkundën drurët e ngrirë pa fletë,
shtëpia sikur nga themelet u zhvendos diku
Dhe tjegulla ranë si breshër përtokë,
ranë
si kokrra rëre
xhamat copë copë.

Dhe —
prapë heshtje.
Në kopësht
çapitej era...

.....

Kështu na erdhi atë natë ilegali,
zbardhur nga pluhuri
si me borë mali...
Nëna hapi derën e mikpritjes,
Ne,
zemrat tona hapëm.

I madh,
ai sikur zbriti nga pirgjet e fantazisë sonë.
Përrallor e njëkohësisht real
hyri
në dhomë.

Gjaku i pikonte nga flokët në ballë
si një lule e panjohur,
si një lule e rrallë.

Naganti ende lëshonte tym,
o, ç'tym mbi atë dorë të nxehtë!...
Një buzëqeshje mes gjakut i kish mbirë —
në fytyrën e heshtur, të qetë.

Na pa të gjithëve.
Asgjë nuk tha.
Gjakun e tij e ndjemë në buzë,
gjaku i tij
në zemër na ra.

Dhe tek e shihnim atentatorin
mendnim: Kë vrau?
Ah, o nagant, na thuaj, pse hesht? ,
Kë rrëzove me fytyrën në pellg?...

Po nëna
si nënat —
e kujdesshme, e ditur, e mirë
vetëm kaq tha:
«ujë, sillni ujë!
Fëmijë, ç'më rrini të ngrirë?»

AMARDA

Asnjëherë s'ishim grindur kaq seriozisht me vëllanë
një pasdite të qetë

si dy historianë.

«Amarda, — më tha, — ky emër ka diçka nga pirgjet
dhe legjionet romake.

ka fërshëllima të kuqe shigjetash buzë një mbrëmjeje
të bardhë,

ka pluhur patkonjsh, thirrje, rrëmuje gurësh që
rrëzohen nga shkëmbenjtë

ka diçka nga qëndresa e kështjellës

tre muaj mbërthyer në rrethim të egër,

ka diçka nga etja e thekshme për një pikë ujë,
ende

luhatjen e shamisë së bardhë të vajzave
që hidhen në krahët e pavdekësisë së humnerave
romakut

pa ju dorëzuar kurrë...

Amarda: një emër me bardhësi vezulluese resh,
me puhi e aroma trëndafilash të egër...»

Dhe fliste vëllai për historinë e vjetër e të re,
unë pyesja i çuditur:

pse? pse?

Kjo është ime bijë, me gjakun që i rreh në aortë,
që i rreh në sytë kafe,

ime bijë me këtë butësi të ngrohtë
në flokë...

Në emrin e saj vura diçka të afërt nga koha jonë e
madhe
pa pyetur për përgjetet e triumfet romake ...

NË KISHËN — MUZE

Që nga muri i akullt me sy të pajetë vështron
ikona
për të mijtën herë në vetminë dhe ankthin e saj
rrëzohet pyetja e zvargur:

Ku jam, ku?
Si gjarpërinj.
gjurmët e rrjedhjes së pikave të ujërave.
Ikona ka ftohtë,
ikona mërdhin.

Nuk jemi turistë.
(Ka kohë që zbrazëtia përplasat në mure ku ka
mbirë bari)

Ne jemi brigada e restaurimit.
Do t'ju pastrojmë, mure.

Në shkëlqimin tuaj
ikona

indiferencën dhe ironinë e vizitorëve do të
shohë.

Ndofta do të ripytes: ku jam, ku?

Po për ditë

nën kërcitjen e hapave që largohen në shkallë
rrëzimin e perëndive

mbi supet e ftohta do të ndjejë.

Dhembja saj

sigurisht miliona herë më e paktë do të jetë
se e shekujve që puthnin profilin e saj të zbehtë...

NDËRSA BINTE DËBORË...

Ndërsa binte dëborë mbi fidanishten e kopshtarit
të vjetër Musa
një degë e hollë, ende e parënduar nga dëborë,
ju përkul plakut mbi supe
dhe qëndroi ai para saj i nemitur.

Ai

zgjati duart e rreshkura dhe përkëdheli njomësinë
e degës së vogël,
ndërsa bora i shkau në gjishtërinj...

dhe atij i ngjau se qe rrethuar nga lulëzimi
i pranverës e jo nga mjergulla e dëborës
dhe pa se frutat po lidheshin në degët e ngjeshura
me lëngun dhe aromën e tokës,

pa vetveten

një pemë të përjetshme

duke rendur nga dimri në dimër

me lulëzimin e pranverës në zemër
drejt brezave...

LIBROMANI

Pluhuri —

rëndon mbi kapakët e vyshkura të librave
të tua

dhe asnjë prej tyre s'e ke fshirë
dhe asnjë prej tyre s'e ke hapur.

Dhe

mbi pluhur

si re të murrme

merimangat kanë tjerrë çatinë
e rrjetave të tyre.

(Sa kohë të qeta o merimanga keni fjetur?)

Duke hedhur vetëm një sy
kushdo mund të thotë:

sigurisht

mes tyre

ti i tëri, libroman, ke mbetur.

BETIMI I KRYENGRITËSVE

Kjo është e tëra: dritën e përjetshme të diellit —
ose errësirën
po drita e diellit është e jona.

Kjo është e tëra: të përqafojmë gjithë hapësirën
e qiellit,
qielli është i yni:
Të mbijnë misri e gruri...
Thundrat e egra të patkonjve
të mos plagosin kurrë bisqet e njoma!

Jetë ose vdekje —
kjo është e tëra...

E DASHUR, MOS FLL...

Diçka nuk kuptuam nga gjuha e erës në fidanet
mbi taraca shpërndarë

diçka nga netët tona
ende s'kemi marrë,
Nga vezullimet e yjeve të rënë mbi det
na mbeti diçka e pakapur,
mos fli, e dashur!

Deti s'ka kohë për të kënduar ninulla sonte.
Dëgjon?.. Na thërret, na thërret.

Do të vish?

E di?

Sytë e komandantes do të përcjellin dashamirës,

Le të joshin mirazhet mjegullore të ëndërrave,
kjo natë është më tepër se gjumi, se qetësia dhe
shlodhja e butë..

E dashur, eja.

NË KOPËSHËTIN ZOOLOGJIK

Të gjitha i pashë:
ariun, që kërkonte degët dhe gjethet e dëndura
të pyjeve,
i trishtuar në vetminë e hekurave të rënda të
kafazit
nën kureshtjen e ndezur të vizitorëve të fundit.

Pashë ujkun
që shqyente pazotësinë e vet nën ato kangjella
të trasha.

Veshët e tij
si antenë kërkonin të kapnin blegërima të
vetmuara delesh.

Ndërsa dhelpra
priste
pëndë të binin poshtë drurëve të ekualiptëve.

Të tëra i pashë.

Megjithatë ndjeva se diçka si oshëtimë më
përshkoi:

po zogjtë, thashë

ku janë zogjtë e fushave të bukura të vendlindjes?

Kur dola

mes cicërimesh isha mbështjellë

Në shtyllat telefonike, mbi pemë, në afishet e reja

të kinemave e në dritaret e hapura, —

cicërima, cicërima.

AGRONOMI

SOKRAT GJEÇIT

Në brazdat e fundit futi duart e ashpra —
dhe heshti.

Toka
gurgullonte
thellë.

Ai
faqen mbështeti pas plisit të butë
dhe ndjeu ngrohtësinë —
diell.

Dhe flokët kur ja pamë që i lëkundte era
na ngjanë sikur befas
kishin mbirë të mbjellat.

MOTIV QYTETAR

Që sonte kemi ardhur të shlodhemi,
dy shokë të mirë.

Të themi të vërtetën,
një kafe na mjafton.
por fike atë buzëqeshje
nga qoshku

në errësirë,
o njeri që s'të njohim,
që me atë vështrim
na mundon.

Ne po shlodhemi.
Ne kafe po pijmë.
e megjithatë —

diçka dimë.

Ti diku kërkon të rrëshqasësh,
ti diku kërkon një cep
larg shqetësimeve të ditës,
larg turneve të natës.

Merre rakinë që na dhe.

Ajo

na përvëlton në ndërgjegje.

Këtë shuplakë të nxehtë

poshtëruese,

idiote

mbaje për vete!

MESKINITET

Erdhi.

Në tërë qënjen e tij, —

ende fërshëllimat e pambruara të

lokomotivës,

lëkundjet e gëzueshme të vagonave

këtë ditë me shi,

ende

shqetësimet e shërbimit të gjatë

diku

në Veri.

Në sytë e tij

avulli

çuf! çuf! i bardhë...

Poshtë syve

rrathët e lodhjes ende s'janë shuar

(si rrathët në ujë kur janë hedhur gurë).

Ja pragu i derës.
Ja ajo —
E ngrohta, e mira kuzhinë.
Dhe
papritur zëri i gruas (i njohur — i largët):
«Ç'më solle? Ç'farë?»
Në ajër
përqafimi
ngrirë.

Rrotull tij rrëshqitën trenat e ngarkuar
të stinës
dhe e rrethuan fërshëllima, fërshëllima.

PRANVERË

Ka në rrugën «Dervish Hekali» një shatërvan
të bukur,
aty
zbret e para pranvera.
Lëshon, e mira, currilat e ujërave
dhe qielli përmbysset mbi shatërvan përnjëherë.

Pastaj në mes të qiellit zënë e mbijnë lule
ngatërrohen petalet e qershive me të pjeshkëve
shtyhen,
lëvizin
deri në retë e bardha
lule, lule.
Si shi i papritur hidhen përpjetë stërkalat e
currilave
dhe del pranvera nga shatërvani, —
o, sa i ngushtë ai!

Pushton bliret në trotuar, vjen e na heq palltot e
trasha e trikotë,
na hap mbrëmjeve të bukura dancigjet,
mbi ekranin e bardhë të kinemave verore filmin e
parë projekton.

Dhe vjen e na hap dritaret e gjëra në zyrë:
ejani, thotë, kërkoni sa më shumë hapësirë,
ka për secilin mijra nuanca e ngjyra —
zgjidhni!

Mbushni zemrat, njerëz punëtorë e të mirë.

PAS PAK...

Shkëmbi. Në zemër të tij —
Mina.

Pas pak
do të bien nga qielli
copëra gurësh
si shira.

Pas pak do të të ngrihet tymi
i murrmë
e i bardhë si mjegulla,
do të bubullojnë 1000 bubullima
dhe ndofta larg
shtëpive
do t'u thyhen papritur tjegullat.

Fitili.
Flaka —

hardhuckë rrëshqet.
Më i vjetri minator
fshin ballin —
dhe hesht...

POETI PARTIZAN

Vargjet nga shpirti i fluturonin si pëllumba
Mes trajektoreve të përflakura të plumbave.

Mbështillej poeti nga vargjet...
Dhe arma më e lehtë i bëhej në duar
dhe urrjetja —
më e rëndë.

Dhe ndodhte:
nga dhembja e thellë për të rënë
strofat
si lule i hidhte mbi ta.

Dhe kënga
përgjysëm e thënë,

ende me gjakun e shokut stërpikur,
nga ciflat e predhave —
përzhitur
në betejën tjetër ringrihej,

merrte shtat
dhe nga fletorja e bardhë e shpirtit të poetit
përhapej në batalion si blerim i papritur...
«O shokë, do marrim hak!..»

Kështu qëmtonte vargjet në fluturim e sipër,
mes trajektorëve të përflakura të plumbave
dhe shushurimës së kallzave të pjekura në
grunaje...

E PËRSËRITSHME

E pritëm mbrëmë. Deri vonë e pritëm.
Kumbulla mbështetej me degët e njoma në dritare
e larë nga drita e dhomës
si me qumësht të bardhë.
Heshtnim: unë dhe gruaja.
Vajza
s'po vinte.
E shqetësuar si një erë dimri
pritja.

Dhe dhoma na dukej më e ngushtë, më e vogël
dhe tryeza me librin në gjysëm, ndërprerë —
bosh,
ndryshe radioposta shtronte valët...
Gjella mbi sobë kishte zënë të ftohej:
Vajza
s'po vinte.

Ne vështroheshim në sy: mos u rrit vallë,
brenda një nate

mos u bë tjetër?

Ndonëse e dinim,
në sytë e saj shkëlqenin tetëmbëdhjetë vjetët.
Dhe nga dritarja e madhe vështronim
kumbullën me lule e bisqe të reja,

ku vesa pikë-pikë binte nga degët, ronitej...

Dhe —

qëndruam. Midis luleve të kumbullave papritur,
në rrugë

atë e pamë...

Si ndërmjet gjelbërimesh.

Ecte ngadalë, vet i dytë...

Dhe vitet u rikthyen. Ne mbi prehërin e butë të
ëndërrimeve kokat ulëm.

U rrit, thamë në heshtje.

Kumbulla zbërthente aroma, shpërndante në ajër
polenin

në drunj të tjerë, që të shtoheshin pemët

dhe kokrrat e dashura të piqeshin —

për njerëzit.

SI FISHKËLLIMAT E TRENAVE

Kështu qofsha: në lëvizje të përjetshme, —
si trenat,
mes fishkëllimave të shqetësuara të kohëve
qëndrofsha
dhe si trenat stacionet
zemrat e mëdha të njerëzve
kudo që të jenë i kërkofsha!

KUR NA U VRA SHOKU

Kur na u vra shoku
në grimca të panumërta u nda stuhia
kur na u vra shoku
zogjtë pushuan këngën
dhe përmes reve të shtërngatës
dielli më afër na u qas.
Dallgët e detit u mbështollën me fasha të bardha
e si një djep
shokun e rënë na përkundën.

Ndërsa dielli u bë i kuq — i kuq,
ndërsa malet u bënë të kuqe — të kuqe
ndërsa dëbora e ngrirë në të kuq humbi...

Dhe në sy na u dogjën luleborat,
tokat e pambjella,

vreshtat,
kurse nëpër rrjeshtat e këngëve
vinte pavdekësia e tij...

POÇEM

Me 14 korrik 1943 në Poçem të Mallakastrës Populli i kësaj krahine bëri besëlidhjen historike për të luftuar dhëmb për dhëmb e pa kompromis kundër okupatorëve dhe tradhëtarëve të vendit...

Këtë vend të dashur malet e kanë vënë në gji,
secili duart duke i zgjatur që ta ketë më pranë,
secili duke i shtrydhur ujërat e argjenta nga zemra,
mjegullat duke i shtrydhur mbi zajet e bardhë...
Mba vesh: borat e shkrira rrëshqasin nën lisa,
gurgullimat e kthjellta të ngjajnë si zëra...
Gjethet e dushqeve kapen me njëra-tjetrën në degët
e dendura,
kapen rrënjët e thella nën tokë,
kapen vetë drurët në hapësirën
transparente,

pa vështro: në drurë nuk ka gjethe,
ato janë duart e besëlidhjes së madhe të 14 korrikut
të luftës.
Janë besëlidhjet e njerëzve, maleve, e burimeve të
nëndheshme,
janë besëlidhja e gjëmimeve dimrore në ditët e zeza
të okupacionit,
besëlidhja e syve, e urrejtjes, e hakmarrjes,
e të rënëve që kokat mbi zaje mbështeten,
duke pirë freskinë e
pavdekshme të maleve;
besëlidhja e atyre që ranë dhe atyre që mblidhen
çdo 14 korrik,
të rrudhur më shumë, të mplakur më shumë e me
thinja si të maleve në kokë,
besëlidhja jonë,
që sa herë kur vemi e dimë që ka diçka nga jeta
e nga gjaku ynë në çdo përvjetor,
besëlidhja e fëmijve që pijnë gurgullimat e ujërave
të tua, Poçem
sikur të pijnë qumështin e ëmbël të gjirit të
nënës...

Sa herë që vijmë tek ti
më shumë lidhemi me njerëzit, me ujërat e me zajet
e bardhë,

me erën që na mbetet në buzë si puthje,
me mjegullat që na pikojnë në kujtimet e bukura
të stinëve,
me shushurimën e gjetheve në shpirt...

MONUMENTI I ÇERÇIZ TOPULLIT

Në sheshin tënd këtë mbrëmje fëmijtë si
zogj të mbështollën me cicërima,

Era
Ndalet në këmbët e tua,
Thyhet si akull i shtypur
cingërima.

Vështrimi yt, Çerçiz
tej hapësirave e kohrave depërton
po ç'ndjeve papritur:
mos dhembja e plumbave
në gjcks e në gjunj
të shpon?
Jo. Ti je mësuar me plumbat.
Plumba —
në jetë, në vdekje, pas vdekjes.
plumbat të ndjekin
në pavdekësi.

DASHURIA

Si ra kështu lumturia, —
drejt e në zemrën time të shqetësuar
si u bie të mbjellave ngrohtësia e diellit,
si u bie luleve freskia e vesës,
që shkundet buzëmbremjes prej qiellit.

Ç'trokitje në mendimet e mia të gjata, —
sikur për herë të parë
po më dilte përballë stuhia.
Dhe atëhere e kuptova:
në veten time
kishte shpërthyer dashuria

YJE NË BAR

Digjen yjet në gusht.
digjet qielli në gusht.
Yjet bien mbi asfalt,
yjet bien nën këmbë
kur zë vesa e mbrëmjes të shkundet...
Vrapojnë fëmijët
si xixëlloja yjet t'i mbledhin në grushta.
Ne jemi mësuar me yjet. I kemi në pellgje,
i kemi në liqenin e bukur artificial, të ankoruara
pas barkave të heshtura,
të ankoruara në molot e qeta të bregdetit,
ku peshkatarët në mesnatën e brishtë i ngatërrojnë
me peshqit...
I kemi kudo yjet. Në liqenin madhështor të Fierzës
qysh tani
yjet projektohen me fytyrat e llampave që do të
vijjnë,

qysh tani
të dashuruarit e ardhmë e ndjejnë pasqyrimin e
tyre në sy,

në faqe,
në flokë.

E dini? Një mbrëmje stallierit plak xha Ndinit i
mbeti tufa e barit në dorë,

E dini? Në shkëlqimin e vesës ai pa kaq yje,
sa s'kish parë një jetë të tërë.

E dini? Atë mbrëmje kish dëgjuar se në Fierzë
makinat e para po çanin në rrugën e re...

A e dini plaku ç'tha?

Këta s'janë yje nga qielli, o lopë të dashura e vija,
ju me barin e njomë përtypni
vezullimet e dritave...

dhe avujt që ngriheshin nga qumështi i ngrohtë në
stallë

ju dukën si abazhurë të mëdhenj.
të bardhë.

KUR KTHEHESHA ME URBANIN E FUNDIT

Kur kthehesha me urbanin e fundit,
qetësisht në prag të mesnatës duke shkarë,
vështroja përjashta
tek mblidheshin mbi drurë flokët e borës
si dorashka të bardha.

Konduktorja
e lodhur dremiste mbi karrigen e meshintë në cep.
Në fytyrën e saj të qetë sikur binin gjithashtu
fluturza bore
si ëndërrime të lehta-të lehta.

IKJA E LEJLEKËVE

Dje ndoqa fluturimin e fundit të bardhë të
lejlekëve.

Ikën, mendova, ikën,
Ndërsa në gjethet e arta
si trokitje të njohura miqsh
pikat e shiut të parë vjeshtor zbritën.

Diçka të madhërishme e të ngrohtë ndjeva
papritur:

vargje lejlekësh
mbi re
e nën re.

Vjeshta përcjell, thashë, ata që dinë të na
dashurojnë
e që pas ndarjesh të gjata
kthehen prapë tek ne

PASQYRA E LËNDËS

	Faqe
— Portreti i Vangjeli Lamit	3
Kur vjen pranvera	6
Njeriu që qeshi përballë vdekjes	8
Lirikë	10
Kundër indiferencës	11
E hershme	13
Një partizan	15
Vdekja e agronomit	17
Ai	19
Papa Kristo Negovanit	21
Për ty	23
Fierzë	24
Motobarka e vjetër e peshkimit	25
Sheshi i taksive në vjeshtë	27
Episod	28
Në autobus	31
Modë	32
— Vetëm dhjetë ditë pranverë	34
Familjare	36
Çast	37
— Këngët e xha Qerimit	38
Unë dhe ti	41

Saldatores së parë që nuk iku nga kantjeri	43
Zgjohu, vajzë!	47
Ne s'mund të heshtim	49
Për thashethemet	53
Ikja nga plazhi	55
Mbrëmje	57
Letër nga ekspedita	59
Për Naum Priftin	62
Pas ca ditësh	65
Pelikanët në tregun e perimeve	66
Vetëm heroi rri zgjuar	68
Alo!	70
Vajza e montatorit	71
Tankistët shkojnë në stërvitje	73
Përcjellja e aksionistëve	75
Monotoni letrare	76
Mallakastra	77
E shkruar për lumin Gjanica	79
Tregim i një nate të vitit 1942	80
Amarda	84
Në kishën — muze	86
Topat në muzeun e Butrintit	88
Ndërsa binte dëborë... ..	90
Libromani	91
Betimi i kryengritësve	93
E dashur, mos fli... ..	94
Në kopshtin zoologjik	95
— Agronomi	97
Motiv qytetar	98
Meskinitet	100
Pranverë	102
Pas pak... ..	104

Poeti partizan	106
E përsëritshme	108
Si fishkëllimat e trenit	110
Kur na u vra shoku	111
Poçem	113
Monumenti i Çerçiz Topullit	116
Dashuri	117
Yje në bar	118
Kur kthehesha me urbanin e fundit	120
Ikja e lejlekëve	121